



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Arkiva Dalëse
 Izlazne Archive
 Output Archives

Nr. Invi/Br. Inv. 01-40005-44605
 Data/Datum/Date 22.08 2025
 Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në baze nenit 8 paragrafi 3.2 të rregullores 04/2017 Mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve shpall këtë :

Thirrje publike

Për dy përfaqësues nga grupi i Eksperteve të jashtëm, një nga OJQ dhe Ekspert për komisionin vlerësues.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthime (ZKKK) ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve të publikuar me date 18.08.2025 me titullin:

Thirrje Publike për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në zbatimin Planin Lokal të Veprimin për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën Gjakovës 2024-2026

ZKKK , fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jene pjesë e komisionit .

Kandidatat e interesuar duhet t'i plotësojnë këtë kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhjen si me poshtë:

- 1.Pervoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë);
- 2.Pervoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë);
- 3.Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare për komunitete të komunës së Gjakovës (15 pikë);
- 4.Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat e komuniteteve (10 pike);
- 5.Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike(20 pikë);
- 6.Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën thirrjes publike(10 pikë);
- 7.Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilën është hapur thirrja publike (15pikë).

Afati i aplikimit : 24.08.2025 deri 07.09.2025

Kandidatat e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kritere:

Duhet të kenë diplomë universitare;

Të kenë përvojë në hartimin e projekteve;

Dokumente e kompletuar duhet të dorëzohen në adresën : Rr. UÇk p.n.50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/Zyra e ZKKK-së ,kati III zyra 34.